



PROCESVERBAL IX/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IX (nëntë) për vitin 2023 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 17.10.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Fidaije Kukaj
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2023;**
- 6. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2023;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - para se të diskutoj,unë dua të flas për një çështje lidhur me Kuvendin e Komunës. Pozita i ka mbrojtë pak a shumë qëndrimet e veta dhe opozita u mundu në një formë me bo opozitën,duke llogaritur me bindje të plotë që asnjëherë nuk kemi kalu në çështje personale por i kemi mbrojtë disa qëndrime të drejta,jo të drejta si opozitë. Rreth dy vite kemi pas raporte shumë të mira me Kryesuesin përveç ndonjë vërejtje eventuale mirëpo dy mbledhjet e fundit situata pak a shumë ka eskaluar, sidomos në mbledhjen e fundit të jashtëzakonshme unë jam zhgënjyer me mënyrën e sjelljes së Kryesuesit. Sjelljet në seancën e fundit e veçanërisht me mua,kanë qenë të papranueshme. Për me pas një funksionim pak më të mirë,unë kisha pas dëshirë që Kryesuesi të bëj një kërkim falje.Sa i përket çështjes si LDK, në kuadër të qëndrimit të fundit,ne i qëndrojmë gjithë atyre çka kemi thënë në dy seancat e fundit dhe me që Kryesuesi nuk ka reflektuar,ne presim që institucionet përgjegjëse me marrë vendime të caktuara lidhur me situatën që ka ndodhur.

Kryesuesi - nëse juve ju ka ardhur si shqetësim,edhe unë e ndiej veten të shqetësuar. Unë nuk dua ta mbroj e as ta justifikoj veten por unë kam dhjetë vite në Kuvend dhe gjatë karrierës time asnjëherë nuk kam pas telashe me asnjë asambleist. Jam mundu me qenë shumë transparent ndaj të gjithë asambleistave e veçanërisht ndaj teje Urim.Alban Berisha ka kërku me zbatu rregulloren e Kuvendit.Unë e kam pas rregulloren por në aspektin kolegial ty të kam dhënë më së shumti hapësirë dhe ti e ke keqpërdor këtë hapësirë.

Urim Suka -sa i përket pikës,unë si shef i grupit të LDK-së nuk e kam asnjë informatë se si kanë shku procedurat rreth kësaj rregullore. Çfarë diskutime janë bë?A u diskutu me ndonjë grup interesi,me klube sportive dhe në cilin nivel ka shku kjo? Më pengon situata se pse është si projekt-vendim kur ne sot kemi me marrë dhe në Kuvend kemi me vendos. Mendoj që për deri sa është një rregullore kaq e rëndësishme,ne duhet me pas informata më shumë,me ardhë në një seancë ku ne të debatojmë për rregulloren dhe ti japim vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe në një seancë tjetër ndoshta e miratojmë.

Ndoshta do të kishte qenë më mirë me na thirrë si KPF ose si asamblesit në ndonjë diskutim publik për rregulloren. Nëse ka mundësi, në seancën që po e dërgojmë, mos me dërgu si projekt-vendim por me dërgu si diskutim këtë rregullore në mënyrë që kur ta marrim vendimin kjo rregullore të funksionojë sa më mirë.

Kryesuesi - faktikisht është formu një grup punues ku udhëheqës i grupit ka qenë Drejtori i Financave dhe e kanë punu këtë rregullore si grup. Kjo rregullore ka qenë në diskutim publik sipas ligjit që e kërkon 14 ditë dhe i ka kalu të gjitha procedurat.

Dardan Berisha - a janë përcaktu të gjitha rregullat ligjore për me ardhë deri në Kuvend?

Kryesuesi - çdo rregullore është e pamundur me ardhë në Kuvend pa i kaluar procedurat ligjore.

Liridon Fandaj - këtu preken shumë kategori dhe ne si asamblist nuk e kemi pas një njoftim. Ndoshta ka qenë njoftim publik por nëse ne kemi me votu, ne duhet ta dimë se kush është grupi punues, kush ka me u marrë me këtë projekt-rregullore dhe të paktën me kontribu edhe ne në këtë projekt-rregullore. Te drejtoria e ekonomisë dhe financave, në shumicën e komunave në regjion, taksat për biznese janë heq dhe janë bo zero. Shoh që disa kategori janë rrit. Disa kategori që janë të ngjashme, si hotele e motele, s'mund të jetë taksa komunale e njejtë për të dyja. Me pas pas një njoftim ndoshta secila kategori do të kishte kontribu në këtë drejtim dhe i kishim pa pakënaqësitë ku janë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - as unë nuk e kam pas informatën që ka pas diskutim publik rregullorja. Realisht ka pas nevojë për me u diskutu ma gjatë sepse kur e mora, pashë që ka disa çështje që ose kanë pikëpyetje ose vërejtje. Edhe unë sikur kolegët, mendoj që duhet me u diskutu pak ma gjatë rregullorja para aprovimit.

Para aprovimit të secilës rregullore përpos që duhet me u mbajtë një diskutim publik, do të ishte mirë që të gjithë asambleistave me ia dërgu ftesën për me marrë pjesë në dëgjim publik, pastaj me u mbajtë edhe një shqyrtim publik në një afat kohor ku Komuna i pret propozimet prej qytetarëve, grupeve të interesit, asamblistëve. Pra është një periudhë ku Komuna i pranon këto propozime, i shqyrton dhe i inkorporon nëse janë të arsyeshme brenda për brenda rregullores. Kam disa pikëpyetje që kisha dasht me i ngritë. P.sh. tarifa për parkingun e automjeteve motorike deri në 3.5 tonë për një orë 50 cent dhe mbi 3.5 ton për një orë 1 €. Ku janë ato zona parkingu dhe kur tariforen, nga kush tariforen dhe si ngasohen ato mjetet? Te bizneset e reja që regjistrohen në emër të grave dhe të rinjëve nën moshën 25 vjeqare, lirohen nga taksa 50% për tre vite. Kjo është shumë e mirë mirëpo lirimi i tërësishëm do të kishte me qenë edhe më i mirë. Bizneset e reja artizanale që regjistrohen për ushtrim të aktivitetit afarist në territorin e Komunës lirohen nga taksat. Edhe kjo është shumë e mirëpritur. Kisha pas dëshirë sa ma shumë këso lloj pikash me pas brenda për brenda rregullores që edhe ne si grup i grave mundemi me dhënë propozime për këtë rregullore. Për Aktin e lëshimit të lejes së ndërtimit për objektet e kategorisë së I-rë dhe II-të 10€, po më duket shumë e paarsyeshme kur një qytetarë i paguan gati 1000€ për lëshimin e lejes së ndërtimit të shtëpisë. Kështu që këtë kategori unë e kisha eliminu. Njejtë vlen edhe për lejen e rrënimin të objekteve. Te pika e fundit 1.13. cilat janë tarifatat përshkak se ky legalizim nuk ka tarifa në tabelën e lartcekur? Sa i përket legalizimit të objekteve propozoj që cila do palë që aplikon në bashkëpronësi (burrë dhe grua), për kategorinë e parë me u liru nga pagesa. Te Drejtoria e Arsimit, neni 26 pika 4 thotë: Nëse familja e ngushtë ka mbi dy studentë në shkollim, e gjithashtu ka edhe tre anëtarë të paaftë për punë, u zbritet tarifa prej 20%, praktikisht do të paguajnë vetëm 80%. Çka ka me pagu? nuk po e kuptoj.

Dardan Berisha - ne që e kemi obligim dhe që jemi pjesë e KPF-së dhe si shefa të grupit, a kemi mundësi ta prezantojmë para anëtarëve të Kuvendit që ne e kemi dhe seancën e rregullt që vje, me i propozu ndryshimet brenda kësaj rregullore? A kemi mundësi këto ndryshime me i bë brenda seancës së rregullt?

Urim Suka - unë kërkoj që seancën e ardhshme ky dokument me shku për diskutim ku ju do ta prezantoni dhe ne ti japim vërejtje dhe sugjerimet tona si asamblist. Pastaj ju ti merrni ato vërejtje dhe sugjerime, ti shqyrtoni me arsyetimet tuaja dhe në seancën tjetër me ardhë, ku ne prap mundemi me diskutu por me u votu herën e dytë. Kjo është vetëm me qëllimin që me dal rregullorja sa më mirë.

Liridon Fandaj - te Drejtoria e Financave dhe Ekonomisë, dikush e regjistron biznesin primar zdrukthëtari dhe i ka edhe dy pompa të benzinës ndërsa taksohet vetëm si biznesi i zdrukthëtaris. Tani na vje një rregullore që dikush po fiton e dikush...

Kryesuesi - kanë dallim rregulloret me rregullore. Ia jep fjalën zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - Siq tha e dhe Kryesuesi, Kryetari e ka formu grupin punues ku edhe unë jam anëtar i këtij krupi punues. Grupi punues ka qenë i themeluar në korrik të këtij viti, ku kemi pas një varg takimesh si grup punues e pastaj edhe takime me drejtorët e drejtorive të cilët kanë qenë të obliguar që ti prezantojnë propozimet e veta për tarifa dhe ngarkesa për drejtoritë që i udhëheqin dhe pas propozimeve ne kemi pas edhe një takim tre ditor si ekzekutiv të cilat i kemi trajtuar dhe kemi ardhë në përfundim që kjo rregullore

të vazhdohet për diskutim publik dhe të vijë në KPF dhe në Asamble për miratim. Nga diskutimi që pashë, nuk e shoh të arsyeshme që të gjitha propozimet dhe rekomandimet që jepen nga anëtarët e Kuvendit të inkorporohen në kuadër të kësaj rregullore për arsye se një pjesë e rregullores është e përcaktuar me akte nënligjore. Rregullorja ka qenë në diskutim publik për 15 ditë. Është e vërtetë që si çdo herë qytetarët nuk interesohen për me dhënë vërejtje dhe sugjerimet e tyre. Propozimet e juaja nëse janë të arsyeshme dhe të domosdoshme, ne kemi me i inkorporu mirëpo pasi ti diskutojmë dhe ti analizojmë ne si grup.

Liridon Fandaj - A është diskutim publik vetëm me vendos një shpallje apo duhet me i ftu edhe grupet e interesit? Secila drejtori është dasht me mbajtë takim me këto që përfshihen dhe taksohen.

Dardan Berisha - më e udhës do t'kish qenë me diskutu para Asamblesë se sa para grupeve të interesit sepse secili aty mundohet mi tkurr tarifafat e veta.

Liridon Fandaj - neni 12 pika 7 thotë: lirohen bizneset që dëshmojnë me dokument të ATK-së TM1, TM2, TM3, TM4.

Avni Bytyqi - nuk lirohen. Nëse ti e dëshmon me këto që tha Liridoni, që ti nuk e ke ushtru aktivitetin tënd atëherë komisioni i formuar nga komuna do ti shlyej obligimet që i ke dhe do ta shlyej edhe firmën.

Liridon Fandaj - ju duhet ta hiqni këtë dhe duhet të kërkonin gjendjen e përgjithshme të ATK-së sepse të biznesit unë mund ti sjell katër 3-mujorët me zero ndërsa atje ka qarkullim.

Labinot Halitjaha - unë kam qenë kryetar i komisionit për këtë rregullore. Kur kam ardhë si drejtor, pas një kohe e kam pa që ka nevojë të bëhen disa ndryshime të vogla. Me kërkesën tonë u formu komisioni dhe kanë vazhdu të gjitha procedurat. Secila drejtori i ka sjell tarifafat e veta, kërkesat, shpjegimet sipas rekomandimeve që kanë pasë. P.sh te financat kemi pas me i shtu disa tarifa te automjetet të cilat nuk kanë qenë. Te pjesa e bizneseve të cilat kanë më shumë shërbime, pak i kemi rrit tarifafat për arsye se shërbimi është më fitimprurës dhe te pjesa tjetër vetëm një pjesë e vogël është prek.

Sanie Rexhepaj - a mund të japësh sqarime te parkingjet për tarifafat për automjetet motorike.

Visar Kuçi - sa i përket parkingjeve ne e kemi vendos si prag ku do të jetë rregullore për parkingje por do të jetë 50 cent si prag dhe do të ndahet në zona.

Sanie Kuçi Rexhepaj - të paktën cekne që është bazë ose prag sepse është shumë e paqartë si definim. Do të jetë e paqartë edhe për zyrtarët që kanë me zbatu rregulloren.

Visar Kuçi - pa e pas një çmim bazë nuk mund të punosh me rregullore.

Sanie Kuçi Rexhepaj - rregullorja është pothuaj e përfundune dhe vetëm tarifafat kanë me u caktu.

Visar Kuçi - propozimet kanë ardhë prej zyrtarëve dhe sa i përket urbanizimit, urbanizmi te shtatë ose tetë pika ka pas ndryshime. Sa i përket legalizimit, te legalizimi kemi mujt me hek që femrat në bashkëpronësi ose në pronësi me u liru prej taksës që vet e rregullon edhe ligji.

Sanie Kuçi Rexhepaj - te çështja e legalizimit ndryshimi mund të bëhet sepse ato janë të definune me ligj. Ministria na ka thënë edhe atëherë që ju mundeni me liru edhe taksën. Te pjesa e shfrytëzimit të hapësirave publike, personalisht mendoj që është mirë me u liru pak taksat.

Visar Kuçi - ne kemi shku nga ajo ku kemi pas probleme më të mëdhaja, te shfrytëzimi hapësirave publike prej 1 deri 10 ditë ku ia kemi lehtësu por edhe i kemi liru.

Urim Suka - kërkojmë që rregullorja seancën e ardhshme me u diskutu dhe seancën tjetër me u miratu.

Visar Kuçi - nuk është korrekte me përmend këtë sepse është formu komisioni nga zyra e Kryetarit, kemi punu dhe 14 ditë ka qenë në dëgjim publik. Unë pajtohem me ndryshu por jo me shqyrtu.

Avni Bytyqi - kur ti ndryshon duhet të kesh arsye sepse tash kur nisim ti ndryshojmë dhe me i pyet grupet e interesit, asnjë nuk pajtohet me vendos tarifa.

Liridon Fandaj - në dëgjim publik është dasht të na ftoni.

Visar Kuçi - është obligim i juaji me hap faqen e Komunës sepse jeni asamblist. 14 ditë ka qenë në shqyrtim publik.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është fakt që komisioni ka punu por janë disa detale që ne para se me dhënë verdiktin final me plotësu sepse asnjë rregullore, asnjë ligj nuk është perfekt, nuk është ideal dhe të metat shihen pasi fillon me u zbatu. Të paktën ta japim edhe ne një kontribut sepse ne po e miratojmë. Është mirë secili shef i grupit parlamentar ti sjell propozimet në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

4 për, 1 kundër, 2 abstenime
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

Dardan Berisha - këtë rregullore e ka bërë Xhajka japoneze në bashkëpunim me Komunën. A ka mundësi që nëse nuk kalon kjo rregullore me u shkëput memorandum bashkëpunimi me Xhajkën ? Trifa për rritjen e pagës së punëtorëve nuk është në rregullore. Që mos ta marrë atë konutacion sepse në Kuvend po flitet vetëm për rritjen e pagës së punëtorëve. Ta kemi parasysh që kjo rregullore është tarif për shpenzimet e tarifës për blerjen e makinerive të ndryshme të cilat i përmban Eko Regjioni.

Kryesuesi - faktikisht ata kanë insistu ta sjellim në Kuvend dhe ka mundësi edhe rrezikohet.

Bulëza Kuçi - ju thatë që rregullorja është e njëjta, pa asnjë ndryshim. Kjo rregullore dy herë nuk e ka kalu pragun mirëpo unë e di që disa herë keni thënë në Asamble që ka me iu rrit punëtorëve pagat. Ne e kemi diskutu në Asamble dhe kemi thënë që nuk kanë me iu rrit pagat punëtorë dhe kemi kërku sqarim. Tash e ngriti Dardani këtë çështje dhe po thoni që s'ka të bëjë me pagat. Kujt ti besojmë dhe si është çështja?

Kryesuesi - çështja e rregullores s'ka të bëjë me paga mirëpo problematikë është sepse shërbimet janë rritur çdo kund.

Dardan Berisha - prej Kuvendit komunal u nxjerr një komision për Eko Regjon. Nuk e di a është funksional ky komision.

Urim Suka - unë pajtohem me atë që tha Bulëza. Dy herë kësaj rregullore ne i kemi thënë jo dhe më duket pak presion me na ardhë herën e tretë me të njëjtin prokurim. Për mua është e pa pranueshme dhe nuk e di a ka bazë ligjore tri herë me sjell. Ne qëndrojmë mbi bazën e asaj se si e kemi propozu më herët. Vota jonë është kundër.

Liridon Fandaj - në projekt-rregullore nuk parashihet askund që këto mjete shkojnë për Eko Regjionin.

Këto janë mjete që ka me i inkasu Komuna dhe ne jemi duke ia rritë një taksë qytetarëve si Komunë dhe jo si kompani Eko Regjion sepse Eko Regjioni merr tender dikund dhe siq e merr Eko regjioni mund ta merr edhe një kompani tjetër.

Dardan Berisha - në këtë rast Eko Regjioni është thirrë në atë sepse janë rrit edhe shpenzime. Pra çdo gjë po shkon duke u rritë ndërsa çmimi po mbetet i njëjtë. Mendoj që 1.50 € nuk është shumë për një familje.

Liridon Fandaj - ti tenderin kur ta qet për mbeturina, dikush mund ta merr me 3 euro. Ti je duke ia inkasu qytetarëve 6 euro.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

3 për, 3 kundër

Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton për.

Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që ka qenë vetëm një propozim dhe ai propozim ka qenë nga Kryetari i Komunës Z. Bali Muharremaj i cili ka propozuar që çmimi “Ukë Bytyçi” për udhëheqje të mirë ti ndahet z. Mufail Gashi. Pas shqyrtimit të propozimit, komisioni i përbërë nga tre anëtarë prezentë ka votuar unanimitisht këtë propozim. Fjalën ia jap anëtarës së këtij komisioni Bulëza Kuçi.

Bulëza Kuçi - ka qenë vetëm një propozim dhe nuk ka pas propozime të tjera. Unë e njoh këtë person. Ka kontribu mjaftueshëm për Komunën dhe mendoj që i plotëson kushtet dhe kriteret dhe kamë qenë pro.

Kryesuesi - atë mendim e ndaj edhe unë me Bulëzën sepse edhe unë si anëtar i komisionit kamë qenë pro.

Dardan Berisha - atë mendim e ndaj edhe unë dhe nuk jam kundër por e di që është bërë shumë zhurmë e që nuk po e lakoj me emër kur është dhënë ky çmim. Keni thënë që ska procesverbal, keni bërë zhurmë. Kjo është politikë. d.m.th kur të vjen njeriu yt duhet mos me bërë zhurmë e asgjë.

Urim Suka - kur unë nuk e kam një informacion për një çështje dhe nuk më ka ardhë procesverbali, patjetër që do ta kërkoj.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimitisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - nuk është vetëm Sania që ka dhënë dorëheqje por është edhe anëtari i dytë, Laureta që ka dhënë dorëheqje.

Visar Kuçi - Komisioni u vonu sepse ka dhënë dorëheqje Festa Kabashi e pastaj u zëvendësu me Laureta Tafën. Si komision kemi punu dhe i kemi mbajtur 7 apo 8 takime dhe kemi ardhë deri në draft të raportit. Kemi qenë në komision: unë, Armendi, Sania, Laureta, mirëpo Dr. Shefket Kolgeci nuk ka marrë pjesë asnjëherë. Ma ka konfirmu që ka dhënë dorëheqje por letër me shkrim nuk ka sjell asnjëherë. Kemi funksionu shumë mirë si komision dhe nuk e di pse Sania ka dhënë dorëheqje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2023;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - Mua më vje keq për raportin që na ka ardhë. Janë bërë nëntë muaj dhe ju i keni hargju 22 % të mjeteve për investime kapitale. Unë e kam kritikuar raportin e tre mujorit të parë i cili ka qenë 1%. Ka ardhë gjashtë mujori me 8%. Tash, mbas nëntë muajve me ardhë me 22% dhe me mbetur vetëm një muaj, kjo është çudi. Ja keni me shkel ligjin, ja kanë me iu mbetur suficit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

3 për, 3 abstenime

Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton për.

Miratohet pika 6

Takimi përfundoi: 4:25

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj